



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2025:032682

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06890928

P.nr.66/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit H.O., me vendbanim në rr:”...” Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.753/24, e datës 12.02.2025, më datë 24.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.753/24, e datës 12.02.2025, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI: H.O., nga i ati N..., e ëma H..., e vajzërisë O..., i data e lindjes..., në fshatin B..., komuna e Mitrovicës, tani jeton në komunën e Vushtrrisë, i divorcuar, me profesion infermier, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 27.12.2023, në rrugën “...”, Vushtrri saktësisht në shtëpinë e tij, i pandehuri me dashje me anë të lidhjes direkt në rrjetin elektrik ka siguruar shërbimeve të rrymës për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit duke shmangur pagesën për këto shërbime, në atë mënyrë ka këputur daljen e njësorit dhe është kyçur në rrjetin elektrik duke anashkaluar , në atë mënyrë ka këputur daljen e njësorit dhe është kyçur në rrjetin elektrik duke anashkaluar njësorin elektrik, me të cilat veprime të dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 207.36€.

- Me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par. 1 të Kodit 06/L-074 Penale të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, 77 dhe nenit 314 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 449 dhe 495 të KPPK-së, e

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË në shumën prej dyqind euro (200 €), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të dëmit të i'a paguaj të dëmtuarës KEDS shumën prej dyqind e shtatë euro e tridhjetë e gjashtë cent (207.36) euro.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit te paguaj shumën prej njëzetë (20) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr.753/24, e datës 12.02.2025, kundër të pandehurit H.O., me vendbanim në rr: "...", komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par.1 të KPRK -së.

Gjykatës i'u është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me besueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri H.O., ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin H.O., i datës 10.01.2025, procesverbali i përgatitur nga zyrtaret e KEDS-it me numër të rastit 2131766, i datës 27.12.2023, fotoalbumi në shtojcë prej 3 fotografive dhe fatura nga KESCO, e datës 28.12.2023 dhe duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”*.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 të KPP-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.66/25, datë 24.02.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.